



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAM ORIENTUES I MATURËS SHTETËRORE
PËR GJIMNAZIN**

LËNDËT:

“QYTETARI”

DHE

“PSIKOLOGJI”

(PROVIM ME ZGJEDHJE)

VITI SHKOLLOR 2020 – 2021

KOORDINATORË: ASTRIT DAUTAJ DHE ESION ZGJANA

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
LËNDA QYTETARIA	3
UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	3
UDHËZIM I VEÇANTË.....	5
REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË	8
PESHA SIPAS TEMATIKAVE	19
LËNDA PSIKOLOGJIA.....	20
UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	20
UDHËZIM I VEÇANTË.....	22
TEMATIKAT E PROGRAMIT	25
REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË	27
PESHA SIPAS TEMATIKAVE	32

LËNDA QYTETARIA

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Qytetaria”, përfshin konceptet më të rëndësishme të lëndës, si dhe njohuritë dhe shprehjet themelore që synohen në këtë lëndë. Ky program është bazuar në programin ekzistues të lëndës “Qytetaria”, të zhvilluar në klasën e 10 të shkollave të mesme.

Programi orientues për provimin me zgjedhje të lëndës “Qytetaria”, i vlefshëm për provimet me zgjedhje në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2020- 2021, përbën një dokument të vlefshëm për shkollën e mesme, për nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e konsultimit ose të vlerësimit për provimet e Maturës Shtetërore.

- Programi orienton **nxënësit** për përvetësimin e materialeve kyçe mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës “Qytetaria”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi përmban informacionin e nevojshëm orientues për **mësuesit** e lëndës “Qytetaria” të shkollës së mesme, që do të përgatisin maturantët për provimin e kësaj lënde me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga **specialistët e vlerësimit**, të përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndës “Qytetaria”, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesuara.

Kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe të tezës së provimit të lëndës “Qytetaria” të cilët **nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program**. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit të përmbajnë njohuri dhe koncepte të parashikuara në programin lëndor dhe të trajtuara në tekstet mësimore.

Mësuesit që do të përgatitin nxënësit për provimin e lëndës “Qytetaria” t’i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por të trajtojnë me ta edhe çështje që nuk trajtohen në tekstin e përzgjedhur, por që

përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e lëndës “Qytetaria” të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve kyçe dhe të aftësive intelektuale të përcaktuara në program.

Kujdes!

Në rastet kur njëri prej teksteve alternative nuk trajton një objektiv të caktuar të programit, atëherë **mësuesi i lëndës, që ka përzgjedhur këtë tekst, ka detyrën të plotësojë informacionin e domosdoshëm për realizimin e objektivit të përcaktuar.**

Nuk është detyrë e nxënësit të sigurojë tekste të tjera për të realizuar objektivat e munguar!

UDHËZIM I VEÇANTË

Testi në provimin me zgjedhje të maturës shtetërore në lëndën “Qytetaria”, do të ndërtohet në bazë të kërkesave dhe objektivave të programit të lëndës “Qytetaria 10”.

Testi **synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e qytetarisë**, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet.

Kjo do të thotë se:

- a. Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës. Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t’u testuar në këtë provim.
- b. Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë në lëndën e qytetarisë në shkollë, të tilla si:
 1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët i aftësive intelektuale).
 2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar i aftësive intelektuale).
 3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë i aftësive intelektuale).

1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (p. sh., ministrat) ose jo të prekshme (p.sh., koncepte, të tilla si: drejtësia, barazia etj.). Të identifikosh diçka, do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.
- **Të përshkruash** do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj.

2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- **Të shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, p.sh.: shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.

- Të **analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike.

3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

- Të **vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, p.sh., për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.
- Të **marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri.
- Të **mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim, ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni, që mund të maten/vlerësohen:

1. me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, të cilët nxënësi, pasi i lexon ose i analizon në një material të caktuar informativ, i plotëson me një ose me më shumë detyra;
2. me anë të testeve me përgjigje të kufizuara;
3. me anë të testeve me përgjigje të zgjeruara.

1. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, janë, për shembull, aftësitë:

- për të dalluar lidhjet shkak-pasojë;
- për të dalluar zbatimin e parimeve;
- për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen;
- për të dalluar hipoteza të arsyeshme;
- për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

2. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të kufizuara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të shpjeguar lidhjet shkak-pasojë;
- për të përshkruar zbatimin e parimeve;
- për të paraqitur argumente të vlefshme;
- për të formuluar hipoteza të arsyeshme;
- për të formuluar përfundime të vlefshme.

3. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të zgjeruara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të prodhuar, për të organizuar dhe për të shprehur ide;
- për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes;
- për të krijuar modele origjinale;
- për të vlerësuar ide të vlefshme.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

TEMATIKA 1: Ligji dhe ne

Tema	Objektiva
Ligji dhe ne	Nxënësi: • shpjegon qëllimin e ligjit; • diskuton për funksionet dhe natyrën e ligjit në shoqëri; • identifikon dhe vlerësojë pasojat e veprimit apo mosveprimit të ligjit në shoqëri; • argumenton me shembuj nga jeta e përditshme domosdoshmërinë e ligjit për shoqërinë; • identifikon dhe diskuton për vlerat që qëndrojnë në themel të ligjeve; • shpjegon domosdoshmërinë e llojeve të ndryshme të ligjit në shoqëri; • demonstroi aftësinë të vlerësojnë vlerat në qëndrimin ndaj ligjeve të caktuara; • identifikon raste të shkeljeve të ndryshme ligjore dhe të diskutojë për pasojat e tyre për veten, familjen dhe mjedisin ku jeton; • evidenton dhe analizon faktorët që ndikojnë në qëndrimin e tij ndaj zbatimit të ligjit.

TEMATIKA: Kushtetuta e Shqipërisë dhe të drejtat e njeriut

Tema	Objektiva
Kushtetuta e Shqipërisë dhe të drejtat e njeriut	Nxënësi: • përshkruan rolin e kushtetutës si ligji themeltar i shtetit; • përshkruan parimet kryesore të mishëruara në kushtetutës shqiptare; • argumenton rëndësinë e mbështetjes në parimet e kushtetutës për hartimin dhe zbatimin e ligjeve; • argumenton domosdoshmërinë dhe rëndësinë e përmirësimit të kushtetutës në përputhje me dinamizmin dhe veçoritë e jetës ekonomike, sociale e politike të shoqërisë.

TEMATIKA 3: Të drejtat e njeriut

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
Të drejtat e njeriut	Nxënësi: • jep një përkufizim të të drejtave të njeriut; • dallon lidhjen e të drejtave të njeriut me nevojat bazë të njeriut; • shpjegon lidhjen e të drejtave të njeriut me vlerat dhe interesat e tyre jetësore të sotme dhe të perspektivës; • interpreton konceptimet e ndryshme për të drejtat e njeriut dhe të shprehë qëndrimin e tij vetjak lidhur me to; • përshkruan tiparet kryesore të të drejtave të njeriut dhe të shpjegojë rëndësinë e secilit prej tyre; • përshkruan përmbajtjen e disa prej dokumenteve themelore të të drejtave të njeriut dhe të institucioneve kryesore evropiane të të drejtave të njeriut; • dallon kategoritë kryesore të të drejtave sipas legjislacionit ndërkombëtar; • përshkruan dhe argumenton rëndësinë e kufizimit ligjor të të drejtave të njeriut dhe sferën dhe kushtet e kufizimit të tyre; • përshkruan, me shembuj në jeta e përditshme, lidhjen e të drejtave të njeriut dhe rëndësinë e saj për realizimin e tyre tërësor; • identifikon dhe shpjegon raste të të drejtave në konflikt dhe të shprehen për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet të drejtave.

TEMATIKA 4: Arsimimi

Tema	Objektiva
Arsimimi	Nxënësi: • argumenton rëndësinë e arsimimit për jetën e secilit; • argumenton të drejtën për arsim si e drejtë themelore; • argumenton rëndësinë e mbrojtjes me ligj të drejtës për arsimim; • përshkruan disa nga realizimet e ligjit shqiptar për arsimin para-universitar; • përshkruan ndryshimet e shkollës në vite; • përshkruan mundësitë që ofron arsimimi në vendin tonë; • dallon rolin e shkollës dhe të mësuesve; • tregon disa nga problemet me të cilat përballet arsimi dhe shkolla jonë sot; • përdor njohuritë dhe mjetet e tjera që ofron shkolla për të bërë zgjedhje për vazhdimësinë e arsimimit të tij; • mbledh fakte e të dhëna për problemet e shkollës e të bëjë interpretimin e tyre; • parashikon pasoja të ndryshme të funksionet e shkollës të qëndrimeve, politikave ose ligjeve të ndryshme.

TEMATIKA 5: Shëndeti

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
Shëndeti	Nxënësi: • jep një përkufizim për shëndetin; • vlerëson shëndetin si një të drejtë njerëzore dhe të tregojë mbrojtjen e tij në dokumentet e të drejtave të njeriut; • argumenton domosdoshmërinë e mbrojtjes me ligj të shëndetit; • tregon si legjislacioni shqiptar e mbron shëndetin; • argumenton rëndësinë e mbrojtjes paraprake të shëndetit dhe e parandalimit të veprimit të faktorëve që e dëmtojnë atë; • argumenton rëndësinë e informimit publik për çështjet e shëndetit; • identifikon dhe të përshkruajë disa nga problemet e sotme në lidhje me shëndetin dhe llojet e tyre; • diskuton për shkaqet kryesore të disa prej problemeve kryesore që lidhen me shëndetin; • dallon disa nga shtresat e pafavorizuara të shoqërisë dhe problemet e tyre që lidhen me shëndetin; • tregon si ligji shqiptar mbron shëndetin e të gjitha shtresave të shoqërisë; • rendit disa nga çështjet bashkëkohore që lidhen me shëndetin dhe shpreh qëndrimin e tij për to; • përcakton dhe diskuton për detyrimet individuale dhe shoqërore për mbrojtjen e shëndetit.

TEMATIKA 6: Mjedisi

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
Mjedisi	Nxënësi: • shpjego lidhjen ndërmjet ruajtjes së mjedisit dhe ruajtjes së vetë njeriut; • vlerëson mjedisin e shëndetshëm si një të drejtë të njeriut ; • tregon si legjislacioni shqiptar mbron mjedisin; • dallon rreziqet me të cilat përballet sot planeti ynë; • identifikon disa nga format e ndotjes së mjedisit në Shqipëri; • rendit disa nga llojet kryesore të ndotjes së mjedisit në bashkësinë ku jeton; • bën kërkime të pavarura ose në grup për mënyrën se si trajtohet mjedisi në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore ose qendrore; • përkufizon me fjalët e tij termin zhvillim i qëndrueshëm; • shpjegon rëndësinë e marrjes parasysh të pasojave të veprimeve dhe sjelljeve tona mjedisore për brezat e ardhshëm dhe për ardhmërinë në përgjithësi; • tregon me shembuj që mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi individuale; • parashikon disa nga pasojat që kanë për brezat e ardhshëm, zgjedhjet që bëjnë individët, grupet ose shteti.

TEMATIKA 7: Konsumatori

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
Konsumatori	Nxënësi: • përshkruan tiparet kryesore të ligjit mbi konsumatorin; • të përcakton përmbajtjen e konceptit konsumator dhe të përshkruajë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit; • përshkruan disa nga faktorët që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit; • demonstroi aftësi të shmangë dhe të zgjidhë probleme të thjeshta si konsumator; • analizon dhe përshkruan elementët kryesorë të kontratës së shitblerjes; • shpjegon elementët dhe rëndësinë e garancisë për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të konsumatorit; • përshkruan funksionet e reklamës dhe të analizojë raste të keqpërdorimit të saj si shkelje e të interesave dhe të drejtave të konsumatorit; • identifikon organizata që punojnë e luftojnë për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit.

TEMATIKA 8: Puna dhe e drejta e punës

Tema	Rezultatet e pritshme të nxënësit
Puna	Nxënësi: • jep një përcaktim të termave punë dhe punoj; • rendit lloje të ndryshme punësh; • dallon faktorët kryesorë që mundësojnë një proces prodhues; • tregon përgjegjësinë e shtetit për punën; • rendit të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve sipas legjislacionit shqiptar për punën; • rendit disa nga hapat e domosdoshëm për të kërkuar punë; • përshkruan tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri; • përshkruan disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë në të; • diskuton për disa nga dukuritë, me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë; • mbledh fakte e të dhëna për problemet e punës së fëmijëve e të bëjë interpretimin e tyre; • parashikon pasoja në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës qëndrime ose praktika të caktuara që lidhen me punën e fëmijëve në familje ose në shoqëri; • përshkruan disa nga të drejtat e tij në punë dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre; • diskuton për rëndësinë e legjislacionit të punës për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të punonjësve; • jep përkufizimin e kontratës sipas legjislacionit dhe të përshkruajë elementët e saj; • rendit disa nga hapat e domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të tij në punë.

TEMATIKA 9: Siguria rrugore

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
Siguria rrugore	Nxënësi: • përshkruan qëllimin e kodit rrugor dhe funksionet kryesore të tij; • përcakton sinjalet kryesore rrugore që rregullojnë qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave; • përcakton sjelljen e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave në rrugë në raport me përdoruesit e tjerë të rrugës; • merr vendim për lëvizjen e tij në rrugë në përputhje me rregullat e qarkullimit rrugor; • gjykon për rregullsinë ose parregullsinë e lëvizjes së përdoruesve të rrugës; • vlerëson dhe të parashikojë pasojat e moszbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor për individët dhe shoqërinë etj.

TEMATIKA 10: E drejta për informim

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
Informimi	Nxënësi: • jep një përshkrim të konceptit informacion; • përshkruan mjetet kryesore tradicionale dhe të reja të informacionit; • flet për mundësitë dhe kufizimet e informacionit; • shpjegon rëndësinë e vlerësimit kritik të informacionit; • shpreh qëndrimin e tij për lirinë e medias dhe për ligjin shqiptar që lidhet me të drejtën e informacionit; • mbledh fakte e të dhëna për problemet e informimit të të rinjve e të bëjë interpretimin e tyre; • parashikon pasoja të ndryshme të qëndrimeve të medias në jetën e fëmijës.

TEMATIKA 11: Bashkëjetesa në komunitet (bashkëpronësi)

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
Bashkëjetesa në komunitet	Nxënësi: • përkufizon konceptet “bashkëjetesës në bashkëpronësi” dhe “bashkëpronarë”; • përshkruan detyrimet e përbashkëta të anëtarëve të komunitetit; • dallon disa prej problemeve kryesore që ndeshen sot në bashkëjetesën në komunitet; • eksploron problemet që ndeshen në komunitetin e tij dhe të analizojë shkaqet kryesore të problemeve që lidhen me bashkëjetesën në këtë komunitet; • përshkruan ligjin për bashkëjetesën në komunitet, funksionet, nenet, pasojat e zbatimit dhe të moszbatimit të tij.

PESHA SIPAS TEMATIKAVE

Nr.	Tema	Pesha (në përqindje)
1	Ligji dhe ne	9%
2	Kushtetuta e Shqipërisë dhe të drejtat e njeriut	7%
3	Familja	15%
4	Arsimimi	7%
5	Shëndeti	9%
6	Mjedisi	9%
7	Konsumatori	10%
8	E drejta e punës	9%
9	Siguria rrugore	12%
10	E drejta për informim	9%
11	Bashkëjetesa në komunitet (bashkëpronësi)	6%
Totali:		100%

LËNDA PSIKOLOGJIA

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Psikologjia”, përfshin konceptet më të rëndësishme të lëndës, si dhe njohuritë dhe shprehjet themelore që synohen në këtë lëndë. Ky program është bazuar në programin ekzistues të lëndës “Psikologjia”, të zhvilluar në klasën e 11-të të shkollave të mesme.

Programi orientues për provimin me zgjedhje të lëndës “Psikologjia”, i vlefshëm për provimet me zgjedhje në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2020 - 2021, përbën një dokument të vlefshëm për shkollën e mesme, për nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e konsultimit ose të vlerësimit për provimet e Maturës Shtetërore.

Programi orienton **nxënësit** për përvetësimin e materialeve kyçe mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës “Psikologjia”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi përmban informacionin e nevojshëm orientues për **mësuesit** e lëndës “Psikologjia” të shkollës së mesme, që do të përgatisin maturantët për provimin e kësaj lënde me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga **specialistët e vlerësimit**, të përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndës “Psikologjia”, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesuara.

Kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe të tezës së provimit të lëndës “Psikologjia” të cilët **nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program**. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit të përmbajnë njohuri dhe koncepte të parashikuara në programin lëndor dhe të trajtuara në tekstet e mësimorë.

Mësuesit që do të përgatitin nxënësit për provimin e lëndës “Psikologjia” t’i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por të trajtojnë me ta edhe çështje që nuk trajtohen në tekstin e përzgjedhur, por që

përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e lëndës “Psikologjia” të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve kyçe dhe të aftësive intelektuale të përcaktuara në program.

Kujdes!

Në rastet kur njëri prej teksteve alternative nuk trajton një objektiv të caktuar të programit, atëherë **mësuesi i lëndës, që ka përzgjedhur këtë tekst, ka detyrën të plotësojë informacionin e domosdoshëm për realizimin e objektivit të përcaktuar.**

Nuk është detyrë e nxënësit të sigurojë tekste të tjera për të realizuar objektivat e munguar!

UDHËZIM I VEÇANTË

Testi në provimin me zgjedhje të maturës shtetërore në lëndën “Psikologjia”, do të ndërtohet në bazë të kërkesave dhe objektivave të programit të lëndës “Psikologjia”.

Testi **synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e psikologjisë**, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet.

Kjo do të thotë se:

Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës. Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t’u testuar në këtë provim.

Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë në lëndën e qytetarisë në shkollë, të tilla si:

- Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët i aftësive intelektuale).
- Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar i aftësive intelektuale).
- Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë i aftësive intelektuale).

Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme ose jo të prekshme (p.sh., koncepte, të tilla si: trashëgimia, personaliteti etj.). Të identifikosh diçka, do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.
- **Të përshkruash** do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende konkrete, por mund të jenë edhe procese etj. Për shembull, nxënësi të jetë i aftë të përshkruajë karakteristikat dhe teoritë e gjumit, të ëndrrave dhe të hipnozës.

Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- **Të shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, p.sh.: shkaqet e ngjarjeve, bashkëveprimin e trashëgimisë me

mjedisin në lidhje me sjelljen, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.

- Të **analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, të analizosh rolin e biologjisë dhe të të nxënit në motivacionin dhe emocionet etj.

Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

- Të **vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, p.sh., për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj. Për shembull, nxënësi të vlerësojë rolin e psikologut dhe të psikiatrit.
- Të **marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri.
- Të **mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim, ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni, që mund të maten/vlerësohen:

- me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, të cilët nxënësi, pasi i lexon ose i analizon në një material të caktuar informativ, i plotëson me një ose me më shumë detyra;
- me anë të testeve me përgjigje të kufizuara;
- me anë të testeve me përgjigje të zgjeruara.

Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, janë, për shembull, aftësitë:

- për të dalluar lidhjet shkak-pasojë;
- për të dalluar zbatimin e parimeve;
- për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen;
- për të dalluar hipoteza të arsyeshme;
- për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të esëve me përgjigje të kufizuara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të shpjeguar lidhjet shkak-pasojë;
- për të përshkruar zbatimin e parimeve;
- për të paraqitur argumente të vlefshme;
- për të formuluar hipoteza të arsyeshme;
- për të formuluar përfundime të vlefshme.

Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të esëve me përgjigje të zgjeruara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të prodhuar, për të organizuar dhe për të shprehur ide;
- për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes;
- për të krijuar modele origjinale;
- për të vlerësuar ide të vlefshme.

TEMATIKAT E PROGRAMIT

Studimi i psikologjisë

Në këtë tematikë, nxënësit njihen me fushën e psikologjisë dhe me zhvillimin që ajo ka pësuar; me çfarë merret psikologjia dhe këndvështrimet me të cilat ajo i sheh fenomenet psikologjike; me degëzimet e psikologjisë dhe me mënyrën se si studiuesit e psikologjisë e pasurojnë diturinë psikologjike.

Biopsikologjia

Në këtë tematikë, nxënësit njihen me bazat biologjike të sjelljes njerëzore dhe me themelin kimik të saj; me mënyrën se si ne vihem në mbahemi në kontakt me botën në të cilën jetojmë; me ndërtimin e aparatit që na ndihmon të kuptojmë botën; me rrugët që ndjekin sinjalet që prej organeve të shqisave e deri në tru; me shqisat e të parit, dëgjuarit, shijuarit, nuhatjes; me perceptimin përkatës dhe me faktorë ndërmjetës në procesin e perceptimit; me konceptet dhe teoritë mbi motivacionin; me motivet për të ngrënë, për të pirë e për të arritur sukses; me marrëdhëniet dhe hierarkinë e motiveve; me natyrën e emocioneve dhe teoritë që i shpjegojnë ato; me mënyrat e shprehjes së emocioneve; me stresin, stresorët dhe reagimin ndaj tyre; me sistemin imunitar dhe sëmundjet; me marrëdhëniet midis modeleve sjellore dhe sëmundjeve të caktuara; me mbrojtjen nga stresi dhe adoptimin e besimeve dhe të sjelljeve të shëndetshme.

Zhvillimi

Në këtë tematikë, nxënësit njihen me ndikimin e faktorëve gjenetikë në zhvillim; me zhvillimin prenatal; me zhvillimin mendor, emocional, social gjatë foshnjërisë dhe fëmijërisë, me zhvillimin gjatë adoleshencës; me zhvillimin në moshën e rritur; me biologjinë e motivit seksual; me faktorët socialë e kulturorë që ndikojnë te seksualiteti; me çrregullimet seksuale; me qëndrimet e shëndetshme seksuale; me shkollat kryesore të shpjegimit të personalitetit: psikodinamike, kognitive, fenomenologjike dhe karakterologjike; me vlerësimin e personalitetit.

Njohja

Në këtë tematikë, nxënësit njihen me kuptimin mbi vetëdijen; me gjumin dhe ëndrrat; me hipnozën dhe gjendjet që krijohen prej drogave psikoaktive; me modelet klasike të të mësuarit: me nxënien e sinjaleve dhe të shoqërimeve (kushtëzimi klasik i Pavlovit) dhe me të nxënit e

pasojava të sjelljes (kushtëzimi veprues i Skinnerit); me të nxënit duke imituar, duke bërë, duke kuptuar.

Të gjitha këto shihen të lidhura me sjelljen e nxënësve në kontekstin e tyre. Përgjatë kësaj linje, nxënësit marrin informacion për natyrën e kujtesës e për mënyrën se si regjistrojmë informacion të ri; për faktorët me ndikim në punën e kujtesës; për mënyrat me të cilat mund të përmirësojmë vëllimin dhe cilësinë e kujtesës sonë dhe të administrojmë harresën; për bazat biologjike të kujtesës etj. Gjithashtu, nxënësit njihen me kuptimin e inteligjencës dhe teoritë mbi të; me funksionet bazë të të menduarit; me përfaqësimet mendore dhe me strategjitë e të menduarit; me testimin e inteligjencës; me situatën problemore dhe me marrjen e vendimeve.

Variacionet mes individëve e grupeve

Në këtë tematikë, nxënësit njihen me kuptimin mbi sjelljen jonormale; me shpjegimin dhe klasifikimin e sjelljes jonormale, me trajtimin e saj; me fenomenet psikologjike që aktivizohen prej të qenit në shoqëri, posaçërisht me perceptimin social, qëndrimet, paragjykimet, tërheqjen reciproke, bindjen, agresivitetin, altruizmin dhe proceset grupore. Fokusi i kësaj linje është sjellja e nxënësve në kontekstet e tyre tipike dhe mundësitë për të përmirësuar këtë sjellje, duke zhvilluar tolerancë dhe mirëkuptim.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

TEMATIKA 1: Studimi i psikologjisë

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
• Hyrje në psikologji • Profesioni i psikologut	Nxënësi: - përshkruan nën fushat kryesore të psikologjisë; - përshkruan zhvillimin e psikologjisë si një shkencë empirike; - shpjegon rëndësinë e mirëqenies shpirtërore dhe të kujdesit që i duhet kushtuar kësaj; - dallon këndvështrimet e sotme të psikologëve për kuptimin e sjelljes dhe të proceseve mendore; - vlerëson rëndësinë e funksionimit psikologjik në jetë.

TEMATIKA 2: Biopsikologjia

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
• Baza biologjike të sjelljes • Ndjesia dhe perceptimi • Motivimi • Emocionet • Shëndeti	Nxënësi: - përshkruan strukturën dhe funksionim e neuronit; - përshkruan organizimin e sistemit nervor; - përshkruan strukturën dhe funksionimin e sistemit endokrin; - përshkruan teoritë kryesore për motivacionin; - argumenton nevojën për përmirësimin e funksionimit mendor; - harton plane për përballimin e stresit personal; - shpjegon reagimet fiziologjike dhe psikologjike ndaj stresorëve; - njeh teknologjitë dhe metodat klinike të studimit të trurit; - shpjegon bashkëveprimin e trashëgimisë me mjedisin në lidhje me sjelljen; - analizon rolin e biologjisë dhe të të nxënit në motivacionin dhe emocionet; - analizon aspektet fiziologjike, afektive, kognitive dhe sjellore të emocioneve; - vlerëson rëndësinë e kujdesit për funksionimin mendor.

TEMATIKA 3: Zhvillimi

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
• Zhvillimi • Personaliteti	Nxënësi: - përshkruan zhvillimin si proces jetësor; - tregon teknikat për grumbullimin e të dhënave për zhvillimin njerëzor; - përshkruan teoritë për zhvillimin njerëzor; - përshkruan mjetet në përdorim për vlerësimin e personalitetit; - vlerëson periudhën personale të zhvillimit dhe rëndësinë që ka ajo për jetën.

TEMATIKA 4: Njohja

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
• Të mësuarit • Ndërgjegjja/vetëdija • Kujtesa • Inteligjenca • Të menduarit	Nxënësi: • përshkruan kuptimin dhe parimet e të nxënit; • rendit pjesët përbërëse të të mësuarit kognitiv; • përshkruan mënyrën si bëhet regjistrimi dhe përdorimi i informacionit të kujtesës; • përshkruan sistemet e kujtesës afatshkurtër e afatgjatë; • rendit tiparet strukturore të gjuhës; • përshkruan teoritë dhe stadet e zhvillimit të gjuhës; • përshkruan natyrën e ndërgjegjes; • përshkruan drogat psikoaktive dhe rolin e tyre në psikikë; • përshkruan natyrën e inteligjencës dhe si testohet ajo; • analizon marrëdhëniet ndërmjet trashëgimisë dhe mjedisit në diferencat individuale; • argumenton për rolin e biologjisë dhe të kulturës në procesin e të nxënit; • analizon metodat e përmirësimit të kujtesës; • shpjegon lidhjet ndërmjet të menduarit dhe gjuhës; • njeh karakteristikat dhe teoritë e gjumit, të ëndrrave dhe të hipnozës; • tregon pse dhe si maten veçoritë individuale.

TEMATIKA 5: Variacionet mes individëve e grupeve

Tema	Rezultatet e pritshme të të nxënit
• Çrregullime psikologjike • Trajtimi i çrregullimeve psikologjike • Ndërveprimi social • Diversiteti sociokulturor	Nxënësi: - përshkruan karakteristikat dhe origjinën e sjelljes anormale; - rendit metodat e përdorura për studimin e sjelljes anormale; - shpjegon kategoritë kryesore të sjelljes anormale; - përshkruan metodat më të shquara për trajtimin e sjelljes anormale; - përshkruan kategoritë shoqërore dhe kulturore; - zotëron njohuri se kush i trajton çrregullimet e sjelljes; - analizon ndikimin shoqëror dhe marrëdhëniet shoqërore; - dallon sjellje të shëndetshme mendore; - vlerëson shëndetin mendor; - vlerëson rolin e psikologut dhe të psikiatrit; - demonstroi qëndrime tolerance dhe joparagjyquese në jetën personale.

PESHA SIPAS TEMATIKAVE

Nr.	Tematika	Pesha (në përqindje)
1	Studimi i psikologjisë	10%
2	Biopsikologjia	31%
3	Zhvillimi	21%
4	Njohja	21%
5	Variacionet mes individëve dhe grupeve	17%
Totali:		100%